



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

DOKUMENTI RREGULLATOR
PËR AKREDITIMIN E AKTIVITETEVE
TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

Për Profesionistët e Shëndetësisë

Ribotim
Shtator 2012



QENDRA KOMBETARE E EDUKIMIT NE VAZHDIM

Ky botim është mbështetur nga projekti
“Sistemi për Zhvillim Profesional”
me fondet e Agjensisë Zvicerane
për Zhvillim dhe Bashkëpunim



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Albania
Zyra e Bashkëpunitit Zviceran në Shqipëri

TRYEZA E LËNDËS

I HYRJE	5
A – Qëllimi i dokumentit	8
B – Koncepte bazë	8
II STRUKTURA E SISTEMIT TË AKREDITIMIT	11
III PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT	13
A – Kërkesa për akreditim	13
B – Vlerësimi i brendshëm	13
C – Vlerësimi i jashtëm	14
D – Publikimi i rezultateve / Përcaktimi i krediteve	15
E – Monitorimi dhe vlerësimi përfundimtar	15
F – E drejta e ankimit	16
IV KRITERET E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM	17
A – Qëllimi dhe objektivat	17
B – Planifikimi i aktivitetit	17
C – Vlerësimi dhe përmirësimi	18
V KRITERET PËR MBËSHTETJEN KOMERCIALE	21
VI AKTIVITETET E EDUKIMIT NË VAZHDIM DHE KREDITET PËRKATËSE	25
VII ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	27
A – Bordi i Ricertifikimit dhe Akreditimit	27
B – Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim	28

C – Ekspertët e pavarur	29
D – Përgjegjësitë e palëve të përfshira në aktivitetet e edukimit në vazhdim	30
ANEKS 1	
TARIFAT E AKREDITIMIT.....	32
ANEKS 2	
PROCEDURAT E VEÇANTA TË AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM TË OFRUAR NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE.....	33

I - HYRJE

Vitet e fundit, Ministria e Shëndetësisë i ka kushtuar vëmendje gjithmonë e më të madhe zhvillimit të burimeve njerëzore në sektorin e shëndetësisë, që ato të përmbushin me sukses funksionet e tyre në ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës¹.

Një nga sfidat më të rëndësishme në përmbushjen e këtij objekktivi është dhe ngritja e një sistemi të edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë, i cili konsiderohet një domosdoshmëri në freskimin dhe përditësimin e njohurive profesionale. Ky objektiv është shprehur qartë edhe në ligjin e ri "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"², nen 33 i të cilit i dedikohet edukimit të vazhdueshem profesional.

Neni 33 Edukimi i vazhdueshëm profesional

1. Ministria e Shëndetësisë krijon programe të detyrueshme për edukimin e vazhdueshëm profesional.
2. Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë të detyruar t'i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rrisin cilësinë e kujdesit shëndetësor.
3. Punësimi, privilegjet ose kontratat në institucionet shëndetësore përfundojnë, nëse stafi profesionist nuk i nënshtrohet procesit të edukimit të vazhdueshëm, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Institucionet e kujdesit shëndetësor u nënshtrohen sanksioneve, në rast se ato punësojnë specialistë, të cilët nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë nen.
5. Institucionet e kujdesit shëndetësor lehtësojnë edukimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve shëndetësorë.

¹ - Strategjia Afatgjatë e Zhvillimit të Sistemit Shëndetësor Shqiptar, Ministria e Shëndetësisë, 2004.

² - Ligji për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, Nr. 10 107, datë 30.03.2009.

Në kuadër të vënies në jetë të sistemit të edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë ngriti në maj 2008 Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim (QKEV), bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 825, datë 14.05.2008¹. QKEV-ja është një institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka për qëllim nxitjen dhe zhvillimin profesional të të gjitha kategorive të personelit të shëndetësisë, me synim rritjen e njouhurive dhe zhvillimin e aftësive të tyre, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Një ndër detyrat e QKEV-së është realizimi i procesit të akreditimit të programeve dhe veprimtarive të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, pa përfshire programet në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe strukturave të saj. Në këtë kuadër, MSH-ja ngriti Grupin e Punës për Akreditimin, i cili hartoи këtë dokument rregulator për procesin e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë. Grupi i Punës për Akreditimin përbëhej nga përfaqësuesit e të gjithë aktorëve kryesorë në këtë proces, në mënyrë që të siguronte një përfaqësim sa më gjithëpërfshirës të palëve të interesuara.

¹ - Ngritura dhe funksionimi i kësaj qendre mbështetet nga Projekti Bilateral për Bashkëpunim dhe Zhvillim ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

A – QËLLIMI I DOKUMENTIT

Ky dokument ka për qëllim të ofrojë një kuadër rregulator për sistemin e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë, që përfshin fushat e mëposhtme:

- Procesin dhe procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim;
- Formulimin e standardeve dhe kritereve të nevojshme për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim (p.sh. standardet pedagogjike, teknike, etike, etj.);
- Përkufizimin e aktiviteteve specifike të edukimit në vazhdim dhe pikët/kreditet përkatëse;
- Rolet dhe përgjegjësitë që lidhen me akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në sektorin e shëndetësisë;

Ky dokument është hartuar bazuar në standardet ndërkombëtare të cilësisë së edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, të publikuara nga QKEV, të cilat kanë për qëllim të orientojnë Sistemin e Akreditimit drejt ndryshimeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme, bazuar mbi eksperientat e jetës reale.

B – KONCEPTE BAZË

Edukimi në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë është procesi përmes të cilit profesionistët e shëndetësisë përditësojnë dijet dhe aftësitë e tyre për të plotësuar nevojat e patientëve, të shërbimeve shëndetësore dhe ato të zhvillimit të tyre profesional. Termi njeh konteksttin multidisiplinar të kujdesit për pacientin që, përvèç njojurive dhe aftësive mjekësore, përfshin edhe aftësitë menaxheriale, sociale dhe personale .

Aktivitete të edukimit në vazhdim janë të gjitha aktivitetet të cilat kanë për qëllim të përbushin nevojat e profesionistëve të shëndetësisë në plotësimin e përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre profesionale. Disa forma të edukimit në vazhdim janë: trajnimi (nga njëditor deri në

tremujor); konferanca; seminari; workshop-i; leksion/ kolegium/ diskutim rasti; aktivitete të të mësuarit në distancë; aktivitet kërkimor.

Akreditimi është procesi i miratimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga ana e institucionit akreditues, bazuar në procedurat, standardet dhe kriteret e paracaktuara.

Institucioni akreditues është institucioni që vlerëson dhe siguron që aktivitetet e edukimit në vazhdim përbushin kriteret dhe standardet e miratuara dhe përcakton numrin e krediteve për pjesëmarrësit (profesionistët e sektorit të shëndetësisë).

Ofrues të aktiviteteve të edukimit në vazhdim janë të gjitha institucionet akademike ose jo akademike, fitimprurëse ose jo fitimprurëse të regjistruara si të tilla në Republikën e Shqipërisë, që kanë eksperțizë dhe eksperiencë në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushën e shëndetësisë. Nga procesi i vlerësimit dhe akreditimit përashtohen të gjitha ato institucione të cilat prodhojnë ose tregtojnë mallra, të cilat përdoren te ose nga pacientët, të cilat konsiderohen si palë të interesit komersial. Këto të fundit mund të mbështesin financiarisht aktivitete të edukimit në vazhdim, në përputhje me politikat e parashikuara nga institucioni akreditues për mbështetjen financiare dhe konfliktin e interesit, por jo të ofrojnë aktivitete të akredituara në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Pjesëmarrësit në aktivitete të edukimit në vazhdim quhen të gjithë profesionistët që punojnë në sektorin e shëndetësisë, si: mjekë, infermierë, stomatologë, farmacistë, por dhe menaxherë dhe ekonomistë të qendrave shëndetësore dhe atyre spitalore etj.

II - STRUKTURA E SISTEMIT TË AKREDITIMIT

Sistemi i akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë ka si funksion organizimin dhe kryerjen e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë bazuar në procedurat, standartet dhe kriteret e paracaktuara.

Sistemi i akreditimit përbëhet nga sistemi i vlerësimit të brendshëm dhe sistemi i vlerësimit të jashtëm.

- Ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të brendshëm, në bashkëpunim me institucionet e vlerësimit të jashtëm.
- Vlerësimi i jashtëm i aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë kryhet nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, sipas procedurave dhe kritereve të miratuara nga MSH-ja dhe BRA-ja.

Struktura e Sistemit të Akreditimit përfshin të gjitha institucionet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo me sistemin e edukimit në vazhdim për punonjësit e shëndetësisë. Këto institucionet kanë një lidhje të ndërsjellë mes tyre, që mundëson mirëfunksionimin e sistemit të akreditimit dhe përfaqësimin e interesave të të gjitha palëve të përfshira.

Ministria e Shëndetësisë është institucioni përgjegjës për udhëheqjen e sistemit të akreditimit.

Bordi i Ricertifikimit dhe Akreditimit, i ngritur nga Ministria e Shëndetësisë, është organi më i lartë vendimmarrës në sistemin e akreditimit, i cili është përgjegjës për miratimin e procedurave dhe kritereve që lidhen me këtë proces.

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim është agjencia teknike e Ministrisë së Shëndetësisë e cila bashkërendon dhe vë në zbatim sistemin e akreditimit, duke kryer akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, sipas procedurave dhe kritereve të miratuara nga MSH-ja dhe BRA-ja.

Shoqatat e profesionistëve, urdhrat përkatës dhe institucionet akademike janë aktorë të rëndësishëm të sistemit të akreditimit, duke u përfaqësuar në këtë proces me pjesëmarrjen e tyre në Bordin të Ricertifikimit dhe Akreditimit, si dhe në përzgjedhjen e listës së ekspertëve, që bashkëpunon me QKEV-në në vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve të edukimit në vazhdim.

Ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim përfshihen në sistemin e akreditimit nëpërmjet kryerjes së vlerësimit të brendshëm, i cili identifikon nevojat për edukim në vazhdim dhe metodat më të mira për përbushjen e tyre. Cilësia e aktiviteteve të planifikuara dhe të zbatuara nga ofruesit ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në kriteret dhe standartet e sistemit të akreditimit, duke i dhënë mundësinë këtij të fundit të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme.

Profesionistët e shëndetit janë aktorë të rëndësishëm të sistemit të akreditimit, sepse ata janë përfituesit dhe nxitësit kryesorë të këtij procesi.

Një diagramë përbledhëse e strukturës së sistemit të akreditimit paraqitet më poshtë, ndërsa rolet dhe përgjegjësitet e palëve të përfshira në këtë proces përshkruhen në mënyrë më të detajuar në kapitullin VI të këtij dokumenti:

SISTEMI I AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË

Ministria e Shëndetësisë

**Bordi
i Ricertifikimit
dhe Akreditimit**

**Ofruesit e Aktiviteteve
të Edukimit në Vazhdim**

**Qendra Kombëtare
e Edukimit në Vazhdim
(QKEV)**

**Profesionistët e Sektorit
të Shëndetësisë**

**Shoqatat dhe Urdhrat e
profesionistëve,
Institucionet Akademike**

III - PROCESI I VLERËSIMIT DHE AKREDITIMIT

A – KËRKESA PËR AKREDITIM

Kërkesa për vlerësimin dhe akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë duhet të bëhet me kërkesën dhe vullnetin e ofruesit, në një afat kohor jo më të shkurtër se 45 dite nga data e planifikuar për zbatimin e tij. Kërkesa për vlerësimin dhe akreditimin e aktivitetit të edukimit në vazhdim bëhet pranë zyrave të QKEV-së ose në faqen e internetit të kësaj qendre. Kërkesa për akreditim duhet të shoqërohet edhe me pagesën e një kuote që varion nga 5000 lekë në 20000 lekë, në varësi të llojit dhe kohëzgjatjes së aktivitetit (shih Aneksin 1).

Për përsëritjen e aktiviteteve që janë akredituar më parë nga QKEV-ja, çdo organizues ka detyrimin të dërgojë në QKEV një njoftim me shkrim, të shoqëruar me programin e aktivitetit, të paktën 7 ditë kalendarike përpara zhvillimit të tij.

Procesi i vlerësimit përbëhet nga vlerësimi i brendshëm dhe vlerësimi i jashtëm dhe duhet të dokumentohet me një dosje vlerësimi.

B – VLERËSIMI I BRENDSHËM

Vlerësimi i brendshëm kryhet nga vetë institucioni ofrues i aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe shërben si bazë për vlerësimin e jashtëm. Procesi i vlerësimit të brendshëm bazohet në formularët dhe udhëzuesit e publikuar nga QKEV për këtë proces. Të dhënat e ofruara nga aplikuesi duhet të pasqyrojnë me vërtetësi informacione mbi tre komponentet kryesore:

1. QKEV-ja shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesipranë kësaj qendre dhe nëse ai është i plotë dhe i detajuar, bënvlerësimin e kritereve të cilësisë në planifikimin e aktivitetit, përfshirë vlerësimin e burimeve të përdorura (trajnerët, materialetpedagogjike) dhe përgatit raportin përkatës 1. Në rast të plotësimit të pjesshëm nga ofruesit të dokumentacionit të kërkuar, QKEV

1. Qëllimi dhe objektivat e aktivitetit

Ofruesi duhet të paraqesë një deklaratë të shkruar të qëllimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim, i cili duhet të përfshijë objektivat e aktivitetit, fushat e ndërhyrjes, audiencën së cilës i drejtohet, llojin e aktivitetit që do të ofrohet dhe rezultatet e pritshme nga ky aktivitet.

2. Planifikimi i aktivitetit

Ofruesi duhet: a) Të demonstrojë një proces planifikimi te aktivitetit i cili gërshton nevojat e identikuara për edukim në vazhdim me rezultatet e parashikuara të aktivitetit; b) Të përdorë të dhëna të bazuara në vlerësimin e nevojave për hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim; c) Të komunikojë qëllimin dhe objektivat e aktivitetit, në mënyrë që profesionistët pjesëmarrës të jenë në dijeni te tyre para ofrimit të aktivitetit; d) Të sigurojë përputhje me politikat e parashikuara nga MSH-ja për mbështetjen financiare dhe konfliktin e interesit.

3. Vlerësimi dhe përmirësimi

Ofruesi duhet: a) Të ketë parashikuar vlerësimin e efikasitetit të aktivitetit të edukimit në vazhdim në përbushjen e nevojave të identikuara paraprakisht; b) Të bëjë përmirësimet e nevojshme, të sugjeruara nga procesi i vlerësimit.

C – VLERËSIMI I JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm kryhet nga QKEV-ja dhe përbëhet nga dy fazë: 1) vlerësimi i dokumentacionit para akreditimit dhe 2) monitorimi i aktivitetit dhe vlerësimi përfundimtar. Faza e parë kryhet para se aktiviteti të akreditohet dhe zbatohet dhe përbëhet nga procedurat e mëposhtme:

1. QKEV-ja shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi pranë kësaj qendre dhe nëse ai është i plotë dhe i detajuar, bën vlerësimin e kritereve të cilësisë në planifikimin e aktivitetit, përfshirë vlerësimin e burimeve të përdorura (trajnerët, materialet pedagogjike) dhe përgatit raportin përkatës 1. Në rast të plotësimit të pjesshëm nga ofruesit të dokumentacionit të kërkuar, QKEV

EAKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

ruan të drejtën e mosvlerësimit me kredite për ato tema të programit që kanë mangësi në dokumentacion.

2. QKEV-ja ngarkon një ose me shumë ekspertë të pavarur të fushës nga lista e përzgjedhur nga Bordi i Ricertifikimit dhe Akreditimit (BRA), për të kryer vlerësimin e përbajtjes së kurikulave që do të përdoren në aktivitet dhe përputhshmérinë e tyre me nevojat e pjesmarrësve.

3. QKEV-ja propozon numrin e krediteve për aktivitetin që do të akreditohet. Mënyra e përcaktimit të numrit të krediteve përshkruhet në kapitullin V.

Dokumentacioni i vlerësimit të brendshëm dhe dokumentacioni i vlerësimit të jashtëm (përfshirë raportet 1 dhe 2), së bashku me numrin e propozuar të krediteve, bazuar në llojin e aktivitetit dhe kohëzgjatjen e tij, përbëjnë dosjen e vlerësimit, miratimi i së cilës mbyll fazën e parë. Faza e dytë përshkruhet në pikën E.

D – PUBLIKIMI I REZULTATEVE / PËRCAKTIMI I KREDITEVE

Bazuar në këto dy aspekte të vlerësimit të jashtëm paraprak, QKEV-ja merr vendimin e akreditimit ose jo të një aktiviteti.

Në rastet kur akreditimi refuzohet, aplikuesit duhet t'i kthehet një përgjigje me shkrim nga QKEV-ja, duke paraqitur arsyet e refuzimit dhe sugjerimet përkatëse për përmirësimin e planifikimit dhe hartimit të propozimeve të ardhshme.

Aktivitetet, të cilat akreditohen, si dhe kreditet përkatëse të tyre, do të bëhen të njoitura në faqen e internetit të qendrës.

QKEV-ja duhet të kryejë procesin e vlerësimit të jashtëm dhe ta bëjë të ditur vendimin e saj brenda 30 ditëve, pas plotësimit të dokumentacionit për akreditim nga ana e ofruesit.

Akreditimi i një aktiviteti është i vlefshëm për një periudhë trevjeçare nga momenti i akreditimit filletar.

E – MONITORIMI DHE VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR

QKEV-ja ka të drejtë të monitorojë zbatimin e aktivitetit, për të siguruar implementimin e standardeve dhe kritereve të parashikuara. Për aktivitete të edukimit në vazhdim që nuk kalojnë në procedurën e vlerësimit të organizimit të aktivitetit nga vetë ofruesit e tyre, QKEV-

ja ka të drejtë të realizojë vlerësimin e organizimit të këtij aktivitetit.

Pas përfundimit të aktivitetit, aplikuesi duhet të plotësojë dosjen e vlerësimit dhe dokumentacionet përkatëse, duke dorëzuar pranë QKEV-së listën e pjesëmarrësve në aktivitet dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të aktivitetit.

QKEV-ja mund të anulojë akreditimin e ofruar, apo të rishikojë numrin e krediteve kur vërehen shkelje të procedurës së mësipërme dhe standardeve bazë të cilësisë, si:

- Ndryshime në programin e aktivitetit që cënojnë cilësinë e tij dhe ndikojnë në përllogaritjen e krediteve të miratuarat.
- Mosraportimi i konflikteve të interesit të organizatorëve ose/ dhe trajnuesve në aktivitet
- Përdorimi i aktivitetit për promovim personal ose komercial
- Keqpërdorimi i emrit të organit kreditues dhe krediteve të njoitura prej tij.
- Mosplotësimi i dosjes me dokumentacionin e nevojshëm përfazën pas aktivitetit.
- Vlerësimi negativ i shumicës së pjesëmarrësve për
 - a. organizimin e aktivitetit,
 - b. përbajtjen e temave të vecanta, apo
 - c. nivelin pedagogjik të paraqitjes së këtyre temave.

QKEV-ja monitoron në menyrë të rastësishme dhe të targetuar vetëm një pjesë të aktiviteteve që zhvillohen.

F – E DREJTA E ANKIMIMIT

Institucionet ofruese të aktiviteteve të edukimit në vazhdim kanë të drejtë të ankohen pranë QKEV-së për përbajtjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Çdo ankirim duhet të paraqitet me shkrim dhe të shoqërohet me të dhëna e argumente që mbështesin ankiminimin. QKEV-ja rishqyrton dosjen e vlerësimit duke marrë parasysh vërejtjet dhe, kur ato janë të mbështetura, i reflekton në reportin përfundimtar.

Në rastet kur akreditimi nuk arrihet sipas procedurave të mësipërme, ofruesi ka të drejtën e ankimit pranë BRA-së.

IV - KRITERET E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM

A – QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Ofruesi duhet të paraqesë një deklaratë të shkruar të qëllimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim, i cili duhet të përfshijë objektivat e aktivitetit, fushat e ndërhyrjes, audiencën së cilës i drejtohet, llojin e aktivitetit që do të ofrohet dhe rezultatet e pritshme nga ky aktivitet.

K1 Ofruesi duhet të paraqesë një deklaratë të qëllimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim, i cili duhet të përmbarë të gjitha komponentet bazë (objektivat, fushat që do të përfshijë, llojin e aktivitetit, rezultatet e pritshme), ku rezultatet të jenë formuluar bazuar në termat e ndryshimeve që aktiviteti do të sjellë në njojuritë ose praktikën e profesionistëve ose përfitimin e pacientëve.

B – PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT

Ofruesi duhet: a) Të përdorë një proces planifikimi që gërs heton nevojat e identikuara për edukim në vazhdim me rezultatet e parashikuara të aktivitetit; b) Të përdorë të dhëna të bazuara në vlerësimin e nevojave në hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim; c) Të komunikojë qëllimin dhe objektivat e aktivitetit, në mënyrë që profesionistët pjesëmarrës të jenë në dijeni përpëra ofrimit të aktivitetit; d) Të sigurojë përputhje me politikat e parashikuara nga MSH-ja për mbështetjen financiare dhe konfliktin e interesit.

K2 Ofruesi duhet të përcaktojë se cilat nevoja për edukim në vazhdim (të shprehura në njohuri, kompetenca ose praktika) do të adresohen në aktivitetin e propozuar të edukimit në vazhdim.

- K3 Ofruesi duhet të hartojë aktivitete të cilat kanë për qëllim të ndryshojnë kompetencat, performancën ose përfitimet nga ana e pacientëve, të parashikuara në qëllimin e dekluarar të aktivitetit.
- K4 Ofruesi duhet të hartojë aktivitete, përbajtja e të cilave të përputhet me fushën në të cilën profesionistët pjesëmarrës ushtrojnë profesionin e tyre.
- K5 Ofruesi duhet të zgjedhë forma edukimi (metoda pedagogjike) të cilat janë të përshtatshme për kontekstin, objektivat dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit.
- K6 Ofruesi duhet të hartojë aktivitete që përputhen me kontekstin e kompetencave të dëshiruara nga profesionistët (p.sh. Udhëzuesit Klinikë etj.).
- K7* Ofruesi duhet të organizojë aktivitete të pavarura nga interesat komerciale.
- K8* Ofruesi duhet të menaxhojë në mënyrë të përshtatshme mbështetjen (financimin, fondet) komerciale.
- K9* Ofruesi duhet ta mbajë të ndarë promovimin nga pjesa edukative e aktivitetit. K10*. Ofruesi duhet të promovojë në mënyrë aktive përmirësimë në shërbimin shëndetësor dhe JO interesat komerciale të ofruesve dhe/ose financuesve të aktivitetit.

C – VLERËSIMI DHE PËRMIRËSIMI

Ofruesi duhet: a) Të vlerësojë efikasitetin e aktivitetit të edukimit në vazhdim në përbushjen e nevojave të identifikuara paraprakisht; b) Të bëjë përmirësimet e nevojshme të sugjeruara nga procesi i vlerësimit.

- K11 Ofruesi duhet të analizojë ndryshimet te pjesëmarrësit (njohuri, praktika ose përfitimet e pacientëve), të arritura si rezultat i të gjitha aspekteve të aktivitetit të edukimit në vazhdim.
- K12 Ofruesi duhet të përdorë njëte vlerësuese të procesit të zbatimit të aktivitetit (p.sh. ambienti, kohëzgjatja, numri i temave, burimet e përdorura).

* Kriteret 7, 8, 9 dhe 10 janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin “Politikat mbi mbështetjen financiare dhe konfliktin e interesit” (Kapitulli IV).

- K13 Ofruesi duhet të identifikojë, planifikojë dhe zbatojë ndryshimet e nevojshme ose të dëshiruara në aktivitet (p.sh. planifikuesit, trajnuesit, infrastruktura, metodat, burimet, mjetet, ndërhyrjet), që janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë të aktiviteteve të ardhshme të edukimit në vazhdim.
- K14 Ofruesi duhet të sigurojë dokumentimin efikas të pjesëmarrësve në aktivitet.

V - KRITERET PËR MBËSHTETJEN KOMERCIALE

QKEV-ja pranon kërkësë për akreditim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim vetëm nga institucione të cilat nuk kanë interes komercial në sektorin e shëndetësisë. Nga procesi i vlerësimit dhe akreditimit përjashtohen të gjitha ato institucione të cilat prodhojnë ose tregtojnë mallra, të cilat përdoren te ose nga pacientët dhe kategorizohen si palë të interesit komercial. Këto të fundit mund të mbështesin financiarisht aktivitete të edukimit në vazhdim në përputhje me politikat e parashikuara nga QKEV-ja për mbështetjen financiare dhe konfliktin e interesit, të përshkruara më poshtë.

Pala e interesit komercial – Në këtë grup përfshihen të gjitha institucionet të cilat prodhojnë produkte ose shërbime të kujdesit shëndetësor, të cilat përdoren te ose konsumohen nga pacientët, si firma prodhuuese ose tregtuese të produkteve farmaceutike, aparaturave mjekësore, produkteve ushqimore dietike ose përfshirë fëmijë. Në këtë grup nuk përfshihen organizatat joftimprurëse ose qeveritare, si dhe kompanitë që nuk zhvillojnë aktivitetin e tyre në sektorin shëndetësor.

Mbështetja komerciale – Është kontributi financiar ose në natyrë, i ofruar nga pala e interesit komercial, i cili përdoret për të paguar të gjitha ose një pjesë të kostove të aktivitetit të edukimit në vazhdim.

Konflikti i interesit – Rrethanat krijojnë një konflikt interesit kur një individ i jepet mundësia të ndikojë në përbajtjen e aktivitetit të edukimit në vazhdim, si dhe në informacionet e ofruara rrëth produkteve apo shërbimeve të palës së interesit komercial, me të cilin ai/ajo ka një marrëdhënie financiare.

Marrëdhëniet financiare – Marrëdhënie financiare janë ato marrëdhënie, në të cilat një individ përfiton nga marrja e rrogës, të drejtat e autorësisë, honoraret si këshillues, interesat për pronësi, apo përfitime të tjera financiare. Marrëdhëniet financiare, zakonisht janë të lidhura me role të tillë si: marrje në punë, rol udhëheqës ose si ekspert i pavarur (duke përfshirë punën kërkimore me kontratë), këshillues, mësimdhënie, anëtarësi në komisionet konsultative, pjesëmarrje në bord dhe aktivitete të tjera prej të cilave pritet ose merret pagesë.

Kriteri 1: PAVARËSIA

1.1. Ofruesi i aktivitetave të edukimit në vazhdim duhet të garantojë se vendimet që do të merren në secilën prej fushave të mëposhtme nuk do të janë nën ndikimin e "palës së interesit komercial".

- (a) Identifikimi i nevojave për edukim të vazhdueshëm;
- (b) Përcaktimi i objektivave të aktivitetit;
- (c) Përgjedhja dhe prezantimi i përmbajtjes;
- (d) Përgjedhja e gjithë personave dhe organizatorëve që mund të kenë ndikim në përmbajtjen e aktivitetit të edukimit në vazhdim;
- (e) Përgjedhja e metodave pedagogjike;
- (f) Vlerësim i aktivitetit dhe objektivave të tij.

Kriteri 2: ZGJIDHJA E KONFLIKTIT PERSONAL TË INTERESIT

2.1. Ofruesi duhet të jetë i aftë të tregojë se çdo person që mund të ndikojë në përmbajtjen e një aktiviteti edukues, ka deklaruar të gjitha lidhjet financiare që paraqesin konflikt interesit për ofruesine aktivitetit.

2.2. Individ i që do të refuzojë të deklarojë lidhjet e mundshme financiare nuk ka të drejtë të jetë anëtar i komitetit të planifikimit, lektor ose autor i aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe nuk mund të ketë kontroll apo përgjegjësi në zhvillimin, menaxhimin, prezantimin apo vlerësimin e aktivitetit.

2.3. Ofruesi duhet të përfshijë një mekanizëm për të identifikuar dhe zgjidhur të gjitha konfliktet paraprake të interesit të aktivitetit edukues që do të ndjekin pjesëmarrësit.

Kriteri 3: PËRDORIMI I DUHUR I MBËSHTETJES KOMERCIALE.

3.1. Ofruesi duhet të marrë të gjitha masat për sigurimin e mbështetjes komerciale.

3.2. Ofruesi nuk duhet të detyrohet nga pala e interesit komercial për të marrë këshilla apo shërbime që lidhen me lektorët, autorët, pjesëmarrësit apo çështjet e edukimit, përfshirë këtu edhe përmbajtjen, si kusht i marrjes së fondeve.

3.3. E gjithë mbështetja komerciale dhe burimet financiare për aktivitetin e edukimit në vazhdim duhet të menaxhohen vetëm nëpërmjet ofruesit (institucionit që ka bërë kërkesën për akreditim pranë institucionit akreditues).

Kushtet mbi dokumentimin e marrëveshjes së shkruar për mbështetjen

3.4. Kushtet dhe qëllimet e mbështetjes komerciale duhet të dokumentohen në një marrëveshje të shkruar midis mbështetësit komercial dhe ofruesit dhe partnerëve të tij. Marrëveshja duhet të përfshijë edhe ofruesin, nëse mbështetja i është dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë partnerit edukues të ofruesit ose ndonjë sponsor i përbashkët.

3.5. Marrëveshja e shkruar duhet ta specifikojë palën e interesit komercial që është burimi i mbështetjes komerciale.

3.6. Mbështetësi komercial, së bashku me ofruesin, duhet të firmosin (nënshkruajnë) marrëveshjen e shkruar midis te dyve.

Kriteri 4: ADMINISTRIMI I DUHUR I PROMOCIONIT KOMERCIAL

4.1. Marrëveshjet mbi prezantimet komerciale ose reklama nuk duhet të influencojnë në planifikimin ose implementimin e një aktiviteti të edukimit në vazhdim dhe as nuk mund të jenë kusht për ofrimin e mbështetjes komerciale për aktivitetin.

4.2. Gjatë aktiviteteve të edukimit në vazhdim është i ndaluar çdo lloj materiali për promocion të produkteve apo reklama të produkteve specifike. Duhet të shmanget ballafaqimi dhe krahasimi i produkteve apo subjekteve të ngjashëm. Aktivitetet promocionale gjatë aktiviteteve të drejtpërdrejta (prova materiale mbështetëse, prezantime) ose reklamat në materialet elektronike apo të printuara, duhet të jenë të ndara nga aktiviteti i edukimit në vazhdim.

- *Në materialet e printuara, reklamat dhe materialet e promocionit nuk duhet të jenë të përziera me përbajtjen e aktivitetit të edukimit në vazhdim. Reklamat dhe materialet e promocionit mund të përfshihen në faqet e para dhe të fundit të materialit të printuar, për aq kohë sa informacioni promocional nuk ka lidhje me përbajtjen e aktivitetit të edukimit në vazhdim.*

- *Në prezantimet elektronike, reklamat dhe materialet e promocionit nuk duhet të jenë të dallueshme në ekran në të njëjtën kohë me përbajtjen e aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe nuk duhet të shfaqen mes prezantimeve elektronike të përbajtjes së aktivitetit.*

- *Në aktivitetet e drejtpërdrejta, reklamat dhe materialet e promocionit nuk mund të shfaqen apo të shpërndahen para, gjatë ose pas hapësirës*

edukative të aktivitetit të edukimit në vazhdim. Ofruesit nuk duhet t'i lejojnë përfaqësuesit e palëve të interesave komerciale të angazhohen në shitje ose aktivitete promocionale gjatë kohës dhe në vendin e zhvillimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim.

4.3. Materialet edukuese, që janë pjesë e një aktiviteti të edukimit në vazhdim, të tilla si prezantime, konspekte dhe shënimë të shtypura, nuk mund të përbajnë asnjë reklamë, emër tregtar apo një mesazh të firmës së prodhimit.

4.4. Materialet e printuara apo në formë elektronike të shpërndara mbi elemente që nuk kanë lidhje me informacionin edukativ të aktivitetit, mund të përfshijnë material të promocionit të produktit ose reklama të produkteve të veçanta.

4.5. Ofruesi i akredituar nuk duhet të lejojë që pala e interesit komercial të ofrojë aktivitete të edukimit në vazhdim te pjesëmarrësit.

Kriteri 5: PËRMBAJTJA DHE FORMATI I PAANSHMËRISË KOMERCIALE

5.1. Përmbajtja apo formati i aktivitetit të edukimit në vazhdim apo materialeve që lidhen me të, duhet të përkrahë përmirësimin apo cilësinë në kujdesin shëndetësor dhe jo një firmë ose agjenci të veçantë të regjistruar biznesi.

5.2. Prezantimet duhet të japin një paraqitje të ekuilibruar të mundësive terapeutike. Përdorimi i emrave të përgjithshëm nuk ndikon anësish. Nëse në materialin edukues të aktivitetit të edukimit në vazhdim apo gjatë prezantimit të tij përfshihen emra tregtarë, duhet të përdoren emra tregtarë të gatshëm nga firma të ndryshme dhe jo vetëm emra tregtarë nga një firmë e vetme.

Kriteri 6: DEKLARIMI I LIDHJEVE FINANCIARE

6.1. Të gjitha lidhjet financiare të mundshme të personave që mund të ndikojnë në aktivitetin e edukimit në vazhdim duhet të deklarohen te pjesëmarrësit në aktivitet, para se ai të fillojë.

6.2. Burimi i mbështetjes komerciale duhet të deklarohet nga ana e ofruesve të aktivitetit të edukimit në vazhdim te pjesëmarrësit në aktivitet, para se ai të fillojë. Deklarimi nuk duhet asnjëherë të përfshijë përdorimin e emrave tregtarë ose një mesazh promocional.

VI - AKTIVITETET E EDUKIMIT NË VAZHDIM DHE KREDITET PËRKATËSE

Aktivitete të edukimit në vazhdim janë të gjitha aktivitetet të cilat kanë për qëllim të përbushin nevojat e profesionistëve të shëndetësisë në plotësimin e përgjegjësive dhe detyrimeve të tyre profesionale. Aktivitetet e edukimit në vazhdim mund të janë të formave të ndryshme. Disa prej tyre janë:

Konferenca - Një aktivitet 1-3 ditor mbi një temë të caktuar, zakonisht e zhvilluar nga shoqata profesionistësh, ku mbahen një seri leksionesh nga ekspertë të fushës, e organizuar në seancë plenare dhe/ose seanca paralele. Qëllimi i konferencës është të shtojë njojuritë e audiencës profesionale kryesisht mbi të rejat e shkencës dhe teknologjisë në lidhje me praktikën përkatëse shëndetësore.

Trajnimi - Një aktivitet edukues (nga 1-ditor deri në 3-mujor) me qëllim përfthimin e *njojurive, aftësive* dhe *shprehive praktike* që nevojiten për të përbushur një detyrë apo punë në mënyrë të kënaqshme. Ai përfshin përdorimin e metodave të ndryshme pedagogjike dhe jo thjesht mbajtjen e leksioneve. Trajnimi mund të zhvillohet larg vendit të punës ose në vendin e punës.

Seminari - Një aktivitet mësimor ku një grup i vogël pjesë-marrësish mësojnë rreth një çështjeje të caktuar dhe marrin pjesë aktivisht nëpërmjet diskutimit të artikujve të caktuar, prezantimit të studimeve të ndryshme, pyetjeve dhe debateve.

Workshop - Një aktiviteti i zhvilluar me një grup të vogël pjesë-marrësish, të cilët përfshihen aktivisht në diskutime, zgjidhje problemesh ose në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi me ndihmën e një eksperti. Qëllimi është që pjesëmarrësit të mësojnë duke provuar, gabuar dhe korrigjuar vetë ose me ndihmën e të tjera e aftësi dhe kompetenca të nevojshme për praktikën e tyre të përditshme.

Aktivitetet e të mësuarit në distancë - Aktivitete edukuese që kryhen në mënyrë të pavarrur nga profesionisti, me ndihmën e teknologjisë moderne. Studimi i materialeve të shkruara, videokasetave, video-konferencat, ueb-konferencat, komunikimi nëpërmjet kompjuterit, e

lejojnë profesionistin të ndjekë një program trajnimi me interes për të, pa pasur nevojë për prezencë fizike në një aktivitet të tillë.

Prezantimi i një leksioni - Një aktivitet që nxit edukimin në vazhdim profesional. Leksioni është një prezantim me gojë nga një profesionist i kualifikuar dhe me përvojë në fushën përkatëse i një teme të caktuar, të përgatitur mirë, për rreth 20 deri në 40 minuta, i shoqëruar me pyetje-përgjigje. Aftësitë komunikuese, prezantuese dhe ekspertiza janë cilësítë kryesore të një lektori të mirë.

Aktiviteti kërkimor/studimor është pjesë e aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Përfshirja e profesionistit në punë kërkimore, në shkrime artikujsh apo materialesh të tjera profesionale dhe shkencore, është një formë tjetër e edukimit në vazhdim. Kriteret e hartuara për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së aktiviteteve të edukimit në vazhdim i kategorizojne këto të fundit në:

Aktivitete të drejtpërdrejta (live) – në të cilat përfshihen të gjitha aktivitetet edukuese që zhvillohen në kohë reale, me angazhimin e të paktën dy personave.

Aktivitete të të mësuarit në distancë – në të cilat procesi i të mësuarit mund të jetë individual ose jo dhe zhvillohet përmes internetit, materialeve didaktike, etj.

Në këtë dokument janë prezantuar vetëm kriteret për vlerësimin e disa prej aktiviteteve të drejtpërdrejta (live) që do te akreditohen fillimisht nga QKEV-ja. Kriteret e vlerësimit të aktiviteteve të tjera të drejtpërdrejta dhe të mësuarit në distancë do të hartohen në vazhdimësi nga QKEV-ja.

Përllogaritja e krediteve për aktivitetet e drejtpërdrejta të edukimit në vazhdim kryhet sipas kriterit një orë – një kredit, bazuar vetëm në orët reale të mësimdhënies dhe duke mos përfshirë pushimet mes prezantimeve, seancën prezantuese të aktivitetit, etj.

VII - ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

A – BORDI I RICERTIFIKIMIT DHE AKREDITIMIT (BRA)

Bordi i Ricertifikimit dhe Akreditimit është organi më i lartë vendimarrës në sistemin e akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë. Bordi përbëhet nganëntë anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

1. Ministria e Shëndetësisë.
2. Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim.
3. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
4. Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.
5. Urdhri i Mjekut.
6. Urdhri i Infermierit.
7. Urdhri i Farmacistit.
8. Fakulteti i Mjekësisë.
9. Shoqatat e Profesionistëve të Shëndetësisë.

BRA-ja ngrihet nga Ministria e Shëndetësisë. Kryetar i BRA-së është përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë.

BRA-ja mblidhet dy herë në vit. Në rastet kur është e nevojshme, kryetari i BRA-së mund ta mbledhë BRA-në dhe më shpesh.

QKEV-ja kryen funksionin e sekretariatit teknik të Bordit të Ricertifikimit dhe Akreditimit.

B – QENDRA KOMBËTARE E EDUKIMIT NË VAZHDIM (QKEV)

Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV) është një agjenci teknike në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.

Në kryerjen dhe ndjekjen e procesit të vlerësimit QKEV-ja gjëzon pavarësi operative në lidhje me procedurat e vlerësimit, hartimin e kritereve dhe standardeve, përbajtjen e raporteve të rezultateve të vlerësimit, bashkëpunimin me Bordin e Ricertifikimit dhe Akreditimit dhe ofruesit e aktiviteteve, si dhe në publikimin e informacionit që lidhet me vlerësimin dhe akreditimin.

QKEV-ja ofron mbështetje teknike lidhur me konceptimin dhe zbatimin e procesit të planifikimit dhe vlerësimit të brendshëm të programave të trajnimit nga ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim, me synim shtimin dhe konsolidimin e ekspertizës teknike në këtë fushë.

Roli i Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim

Roli i QKEV-së në lidhje me sistemin e akreditimit është:

- Vlerësimi, planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim, përmes: 1) koordinimit dhe/ose kryerjes së studimeve për vlerësimin e nevojave në lidhje me edukimin e vazhduar profesional; 2) identifikimi i prioriteteve dhe propozimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim që u përgjigjen këtyre prioriteteve; 3) ofrimi i kontributit në hartimin dhe garantimin e zbatimit të një plani kombëtar në fushën e edukimit në vazhdim; 4) mbështetja në koordinimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim të financuara nga marrëveshjet me donatorë të ndryshëm, agjencitë e tyre implementuese, si dhe organizata të tjera shqiptare dhe të huaja.
- Zbatimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim, nëpërmjet: 1) kontributit në procesin e kontraktimit të universiteteve, shkollave, organizatave të huaja dhe shqiptare, si dhe të ekspertëve individualë në fusha specifike; 2) monitorimit dhe superivizionit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, në mënyrë që të sigurojë implementimin e standardeve dhe kritereve të parashikuara nga

QKEV-ka; 3) sigurimit të vazhdimësisë së kontratave me organizatat e përfshira ose konsulentët individualë.

- Akreditimi i aktiviteteve të edukimit në vazhdim, nëpërmjet: 1) hartimit dhe garantimit të zbatimit të kritereve dhe standardeve të cilësisë për aktivitetet e edukimit në vazhdim; 2) formulimit dhe publikimit të udhëzuesve në lidhje me standardet e vlerësimit të jashtëm e të brendshëm të cilësisë dhe kriteret e akreditimit; 3) përcaktimit të krediteve përkatëse për format e ndryshme të aktiviteteve të edukimit në vazhdim; 4) publikimit dhe përditësimit të listës së aktiviteteve të akredituara të edukimit në vazhdim për profesionistët e ndryshëm të kësaj fushe.
- Zhvillimi i teknikave pedagogjike, nëpërmjet: 1) zhvillimit dhe përqendrimit të ekspertizës në fushën e pedagogjisë për të rritur (andragogji), me qëllim përforcimin e njohurive dhe aftësive të trajnerëve në sektorin e shëndetësisë; 2) vlerësimit të cilësisë së aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga pikëpamja pedagogjike, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe plotësimin e nevojave të përfituesve.
- Miratimi i akreditimit për aktivitetet e edukimit në vazhdim. Vendimi për miratimin e akreditimit merret pas shqyrtimit të dosjes së vlerësimit dhe raporteve të përpiluara nga stafi i qendrës dhe ekspertët e pavarur.

C – EKSPERTËT E PAVARUR

Ekspertët e pavarur janë përgjegjës për vlerësimin e përbajtjes së kurikulave që do të përdoren në aktivitet dhe përputhshmërinë e tyre me nevojat e pjesëmarrësve dhe përpilimin e raportit 2 (siç përshtkuhet në Kapitullin 2).

Ekspertët që do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të një aktiviteti të edukimit në vazhdim zgjidhen me rotacion, nga lista e ekspertëve të secilës fushë ekspertize të miratuar nga Bordi i Ricertifikimit dhe Akreditimit, në bashkëpunim të ngushtë me shoqatat e profesionistëve, urdhrat përkatës dhe institucionet akademike. Lista e ekspertëve rishqyrtohet çdo dy vjet.

Ekspertët e përfshirë në procesin e vlerësimit të jashtëm të një aktiviteti të edukimit në vazhdim, ashtu si dhe të gjithë aktorët e tjerë

të përfshirë në këtë proces, duhet të deklarojnë para përpilimit të raportit çdo konflikt të mundshëm interes i ofruesin e aktivitetit të edukimit në vazhdim. Gjithashtu, eksperti i përzgjedhur për vlerësimin e jashtëm të një aktiviteti nuk duhet të jetë i përfshirë në planifikimin, organizimin dhe zbatimin e të njëjtë aktivitet.

Roli i ekspertëve të pavarur

Roli i ekspertëve të pavarur në lidhje me sistemin e akreditimit është:

- Vlerësimi i kurikulave të propozuara për aktivitetin e edukimit në vazhdim.
- Vlerësimi i përputhshmërisë së kurikulave të propozuara me kategorinë e pjesëmarrësve të planifikuar që të marrin pjesë në këtë aktivitet.
- Përpilimi i raportit përkatës (raporti 2) të vlerësimit të jashtëm.

D – PËRGJEGJËSITË E PALËVE TË PËRFSHIRA NË AKTIVITETET E EDUKIMIT NË VAZHDIM

Përgjegjësitë e institucioneve akredituese janë:

- Tëjenë të drejtë, të paanshëm, inovatorë dhe të qëndrueshëm në praktikat akredituese;
- Të hartojnë standarde dhe kritere të arsyeshme për ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim;
- Të demonstrojnë besueshmëri, përgjegjshmëri dhe aftësi udhëheqëse ndaj procesit të akreditimit;
- Të përfshijnë në procesin e akreditimit verifikimin e përmbrushjes së përgjegjësive të ofruesit të aktivitetit;
- Të promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të sistemit të akreditimit, si dhe të sistemeve edukuese që ai mbështet;
- Të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën me institucionet tjetra organizuese, me ofruesit e aktiviteteve dhe grupet e interesuara.

Përgjegjësitë e pjesëmarrësit (profesionistit të shëndetësisë) në aktivitetet e edukimit në vazhdim janë:

- Të marrë pjesë në aktivitete të edukimit në vazhdim në përputhje me nevojat e tij individuale për edukim të vazhduar;
- Të sigurohet që nevojat e identifikuara të janë në përputhje me praktikën e tyre profesionale dhe të kenë për qëllim final përmirësimin e shërbimit dhe shëndetit të pacientëve;
- Të vlerësojë shkallën e përmbushjes së nevojave, bazuar në ndryshimin e njohurive, kompetencave dhe praktikave të punës.
- Të verifikojë/sigurohet që aktivitetet nuk përdoren për qëllime komerciale.

Përgjegjësitë e ofruesit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim janë:

- T'u deklarojë institucioneve akredituese dhe pjesëmarrësve çdo interes ose mbështetje komerciale të planifikuesve, prezantuesve / trajnuesve, ose lehtësuesve të aktivitetit.
- Të raportojë tek institucionet akredituese dhe pjesëmarrësit çdo mbështetje, sponsorizim ose financim nga organizata shëndetësore fitimprurëse dhe të sigurohet që ato nuk ndikojnë në strukturën dhe përbajtjen e aktivitetit.
- Të sigurojë ekzistencën e treguesve të matshëm të efikasitetit në përmbushjen e objektivave të aktivitetit që lidhen me ndryshimin e njohurive, kompetencave dhe praktikave të punës.
- Të sigurohet që objektivat e edukimit janë të përkufizuara në terma njohurish, kompetencash ose praktikash dhe janë të përshtatshme për grupin e profesionistëve që i referohet.
- Të sigurohet që metodat pedagogjike të përdorura janë të përshtatshme me objektivat e deklaruara.
- Të jetë i aftë të tregojë se ka vlerësuar cilësinë e aktiviteteve të mëparshme dhe ka bërë përmirësimë aty ku ka qenë e nevojshme.

ANEKS 1

TARIFAT* PËR AKREDITIMIN E AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM NGA QKEV

Lloji i aktivitetit	Nr. i pjesëmarrësve	Kohëzgjatja në ditë	Tarifa përkreditim
Konferanca/Kongrese	<100	-	10000
Konferanca/Kongrese	>100	-	20000
Trajnime/Workshops/Seminare	<50	1-3	5000
Trajnime/Workshops/Seminare	<50	4-6	8000
Trajnime/Workshops/Seminare	<50	7-15	12000
Trajnime/Workshops/Seminare	<50	15-30	15000
Trajnime/Workshops/Seminare	<50	>30	20000

* Pagesa e kryer nga ofruesi gjatë fazës së aplikimit mbulon shpenzimet operative të QKEV-së gjatë procedurave të vlerësimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe është e pavarur nga vendimi për miratim ose jo të akreditimit për aktivitetin. Plotësimet e dosjes gjatë fazave të ndryshme të vlerësimit, si dhe rivlerësimi në rastet e ankimimeve, përfshihen në pagesën fillestare të aplikuesit.

* Përjashtohen nga tarifat për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim të gjitha institucionet shëndetësore publike, të cilat organizojnë aktivitete të edukimit në vazhdim vetëm për profesionistët e organizatës sëtyre.

ANEKS 2

PROCEDURAT E VECANTA TË AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM TË OFRUAR NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE PËR PERSONELIN E TYRE.

Në këtë shtojcë paraqiten vetëm ato elementë ku procesi i akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim të ofruara nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor ndryshon nga procedurat e paraqitura në "Dokumentin rregullator për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë". Për çdo element të patrajtuar në këtë shtojcë, përcaktimet e dokumentit rregullator të akreditimit të sipërpërmendur mbeten në fuqi.

Qëllimi i hartimit të kësaj shtojce është të lehtësojë procesin e akreditimit për aktivitetet e edukimit në vazhdim të ofruara nga institucionet publike për personelin e tyre.

LLOJET E AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

Aktivitetet që mund të organizohen nga institucionet shëndetësore publike për personelin e tyre janë:

- *Seminari*
- *Mbledhje klinike*
- *Studim rasti*
 - *Aktivitete mësimore në grupe të vogla (leksione/prezantime të studimeve shkencore / materiale shkencore në video, etj)*
- *Trajinim*
- *Trajinim në punë e sipër*

OFRUESI I AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM

Këto aktivitete organizohen nga institucionë publike që ofrojnë kujdes shëndetësor apo menaxhojnë atë, të tilla si:

- *Qendra publike shëndetësore të kujdesit parësor*
- *Spitali publik rajonal dhe lokal*
- *Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" dhe spitalet e tjera universitare*
- *Ministria e Shëndetësisë dhe institucionë në varësi të saj (ISHP, ASHR, etj)*
- *Drejtori të rajonale të shëndetit publik*

PJESËMARRËSIT NË AKTIVITETET E EDUKIMIT NË VAZHDIM

Në aktivitetet e edukimit në vazhdim të ofruara nga institucionet shëndetësore publike, për të cilat aplikohen procedurat e vecanta të akreditimit, duhet të marrin pjesë vetëm profesionistët e institucionit që e ofron aktivitetin e edukimit në vazhdim, ose institucioneve, në rastin kur aktiviteti organizohet nga më shumë se një institucion.

Pjesëmarrja e profesionistëve të institucioneve publike në këto aktivitete duhet të jetë pa pagesë.

PROCESI I VLERËSIMIT DHE I AKREDITIMIT

• Kërkesa për akreditim

Kërkesa për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga institucionet publike të kujdesit shëndetësor (ofruesit) duhet të kryhet në dy faza:

Faza e parë: Ofruesi plotëson formularin e aplikimit (*shiko Udhëzuesin për vlerësimin e brendshëm të aktiviteteve të edukimit në vazhdim*), harton një program vjetor të aktiviteteve të edukimit në vazhdim dhe i dërgon pranë QKEV-së.

- Për të gjithë aktivitetet e planifikuara të zhvillohen gjatë një viti plotësohet vetëm një formular aplikimi.

- Në programin vjetor ofruesi duhet të përcaktojë:
 - a) temat e aktiviteteve,

- b) lektorët përkatës për cdo aktivitet
- c) periudhën (kjo mund të jetë dhe e përafërt) e zhvillimit të tyre.

- Ofruesi duhet të dërgojë formularin e aplikimit bashkë me programin vjetor përkatës brenda periudhës dhjetor i vitit paraprak - janar i vitit në vazhdim. (*P.sh. për aktivitetet që do të planifikohen për vitin 2013, duhet të aplikohet nga dhjetori i vitit 2012 deri në fund të janarit të vitit 2013*)

Faza e dytë: Në këtë fazë ofruesi dërgon pranë QKEV-së të gjithë dokumentacionin e detajuar që përcaktohet në formularin e vlerësimit të brendshëm. Ky dokumentacion përbëhet nga:

- i) programi i detajuar i çdo aktiviteti që bën pjesë në programin vjetor të aktiviteteve, ku duhet të përcaktohet kohëzgjatja e prezanti-meve, diskutimeve apo punës praktike që do të zhvillohet gjatë aktivitetit;
- ii) një informacion të përbledhur (abstrakt) për çdo temë trajnuese të planifikuar;
- iii) një informacion të përbledhur për historikun profesional të profesionistëve që do të janë në rolin e lektorëve;
- iv) materiale promovuese apo referenca (nëse ka të tilla) që do t'u shpërndahen pjesëmarrësve.

- Në rastin kur programet e aktiviteteve të planifikuara janë të njëjtë në format dhe kohëzgjatje, (*si p.sh. leksione që zgjasin 1 orë e 30 minuta të shoqëruara nga 30 minuta diskutim*), ofruesi mund të dërgojë vetëm një program që do të konsiderohet i vlefshëm për të gjithë aktivitetet e organzuara prej tij.

- Në rastin kur ofruesi planifikon të zhvillojë aktivitete të formave të ndryshëm si: seminare, trajnime në punë e sipër, leksione etj, ai duhet të dërgojë programe të vecantë për çdo aktivitet sipas formatit dhe kohëzgjatjes së planifikuar për të.

- Ofruesi duhet të dërgojë minimalisht 1 javë përpëra zhvillimit të secilit aktivitet dokumentacionin përkatës për atë aktivitet, ashtu siç listohet më lart.

- Pas zhvillimit të çdo aktiviteti, ofruesi ka detyrimin të dërgojë pranë QKEV-së një listë të pjesëmarrësve për cdo aktivitet. Lista duhet të mbajë vulën e institucionit dhe firmën e titullarit.

- Ofruesit e sipërpërmendur të këtyre aktivitetave janë të përshtuar nga pagesa për procedurën e akreditimit.

• Vlerësimi dhe përmirësimi

Në mbarim të procesit të zhvillimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, ofruesi duhet të dërgojë vetëm një përbledhje të vlerësimit nga pjesëmarrësit mbi organizimin e këtyre aktiviteteve. Në këtë përbledhje ofruesi duhet të paraqesë mendimin e pjesëmarrësve rreth organizimit të aktivitetit, efektivitetit të tij, si dhe të paraqesë sugjerimet e tyre për përmirësimë në të ardhmen.

• Vlerësimi i jashtëm dhe akreditimi

QKEV shyrton dokumentacionin e paraqitur dhe në rast se vlerëson se materialet profesionale që do të paraqiten në aktivitet janë të

a) akredituara paraprakisht prej saj;

b) materiale të përgatitura dhe paraqitura në botime shkencore të certifikuara brenda ose jashtë vendit;

c) janë protokolle apo udhëzues të hartuar nga MSH/Institucionet e varësisë së MSH, apo Qendrat Spitalore Universitare;

e kryen akreditimin e tyre bazuar vetëm në raportin 1 të vlerësimit të jashtëm (pika III.C)

Në rastet e tjera procedurat e vlerësimit të jashtëm kryhen ashtu siç është përcaktuar në dokumentin rregulator.

QKEV përcakton numrin e krediteve për çdo aktivitet në veçanti, bazuar në programin apo programet e detajuar të aktiviteteve për të gjithë vitin, mbi bazën e kriterit 1 orë – 1 kredit.

QKEV-ja duhet të kryejë procesin e vlerësimit të jashtëm dhe ta bëjë të ditur vendimin e saj brenda 45 ditëve, pas plotësimit përfundimtar të dokumentacionit për të gjithë aktivitetet e planifikuara në një dosje aplikimi.

MONITORIMI

QKEV ka të drejtë të monitorojoë aktivitetet e ofruara dhe zhvilluara në institucionet shëndetësore publike, për të siguruar zbatimin cilësor të standardeve dhe kritereve të parashikuara. QKEV-ja rishikon numrin e krediteve ose anulon akreditimin në rast se vihen re shkeljet që përcaktohen në Dokumentin rregulator të akreditimit si dhe në rastet e mëposhtme:

- Zhvillimi i aktivitetit me një pjesëmarrje të ndryshme nga ajo e parashikuar

- Aplikimi i pagesës për pjesëmarrje.